



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME MIRDITË SHA
ASAMBLEJA E PËRGJITHËSHME

Nr. 105 Prot.

Lezhë 23 / 03 / 2023

VENDIM

Nr. 2, datë 23.03.2023

Bazuar ne ligjin nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar, ne vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.302, date 11.05.2022 "Politikat Kombetare per Riorganizimin e Sektorit te Furnizimit me uje dhe largimit, trajtimit e perpunimit te ujerave te ndotura, ne marreveshjen date 22.07.2022 "Per krijimin e subjekteve me kompetenca te perbashketa te ujesjelles kanalizimeve, lidhur ndermjet Bashkise Lezhe, Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise , Bashkive Kurbin dhe Mirdite, si dhe ne aktmarrveshjen e bashkepunimit per transferim aktiviteti date 03.10.2022 ndermjet ndermjet Shoqeria Ujesjelles Kanalizime Mirdite sh.a. me NIPT J69303012L, dhe Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Lezhe sh.a. me NIPT M28314503C , duke qene para faktit se Shoqeria Ujesjelles Kanalizime Mirdite Sh.a. e ka transferuar veprimtarine ekonomike si dhe aktivet dhe detyrimet e saj ne teresi nga data 01.01.2023 per ne Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Lezhe sh.a., ne raportin e transferimit te veprimtarise ekonomike te pregatitur nga Audituesi Ligjor, kjo shoqeri nuk ka me te drejte te zhvilloje aktivitetin per te cilin ajo eshte themeluar dhe se per sa konstatohet si me sipër, shoqëria Ujesjelles Kanalizime Mirdite sh.a. me NIPT J69303012L, e ka përmbushur qëllimin e krijimit dhe nuk ka më arsye të vijojë ekzistencën e saj dhe duhet të prishet dhe të cregjistrohet nga regjistri tregtar QKB, Asambleja e Pergjithshme si ortak i vetem pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe pas diskutimeve

VENDOSI:

1. Përfundimin e aktivitetit të shoqërisë dhe prishjen e saj
2. Shoqëria shpall hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese;
3. Likuidator i Shoqerise emerohet z. Nikolin Kaçorri aktualisht Administrator I kesaj shooqërisë.
4. Autorizohet Likuidatori i Shoqerise të përgatisë Raportin Përfundimtar të likuidimit të shoqërisë. Ai është gjithashtu i autorizuar të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme në perputhje me legjislacionin e aplikueshëm për likudimin e shoqërisë si dhe të kërkojë, paraqesë çdo dokument të nevojshëm pranë autoriteteve private dhe publike në lidhje me likudimin e shoqërisë.
5. Autorizohet likuidatori i Shoqerise per kryerjen e veprimeve perkatese ne perputhje me parashikimet ligjore ne QKB.
6. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

KRYETARI I BASHKISE MIRDITË
Z.Ndrec DEDAJ

